

274/4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 1622/Prot.

Data 23/02.2015

Lënda: Kthim Përgjigje në lidhje me Kërkesën tuaj datë 10.11.2014

✓ Drejtuar: Znj. Lindita Çela
Qendra "Res Publica"
Adresa: Rr. "Nikolla Tupe", P. nr. 4, shk. 1, Ap. 5

TIRANË

Për Dijeni: Z. Besnik Dervishi
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave
Personale

TIRANË

E nderuar znj. Çela!

Në lidhje me Kërkesën tuaj datë 10.11.2014, ju njoftojmë se Prokuroria e Përgjithshme realizoi procedurën e rishikimit të klasifikimit të informacionit të klasifikuar "sekret", të kërkuar nga ana juaj.

Referuar Procesverbalit Nr. 1622/8ex-14 Prot. datë 16.02.2015 të Komisionit i cili rishikoi klasifikimin e informacionit të klasifikuar "sekret", të kërkuar nga ana juaj, ju bëjmë me dije se:

1. Prokuroria e Përgjithshme mbikqyr dy lloje përgjimesh; përgjimet procedurale dhe përgjimet parandaluese.
2. Komisioni pranë Prokurorisë së Përgjithshme i ngritur për rishikimin e informacionit të klasifikuar "sekret" konkludoi se numri i përgjimeve procedurale është publik dhe mund të jepet. Për periudhën 01.01.2014 - 31.10.2014 është mundësuar interceptimi si mjet për kërkimin e provës në hetimet paraprake ndaj 3140 personave (kundrejt 2315 e 3112 respektivisht në vitet 2012 dhe 2013), aplikuar në 689 procedime penale.
3. Komisioni pranë Prokurorisë së Përgjithshme i ngritur për rishikimin e informacionit të klasifikuar "sekret" konkludoi se numri i përgjimeve parandaluese, referuar:
 - o Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, neni 10;

- Kushtetutës së RSH, nenet 23/2, 17 dhe 35;
- Kodit të Procedurës Penale, nenet 160, 294, 295;
- Kodit të Procedurës Administrative, nenet 19, 20, 55;
- Ligjit 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike”, neni 3;
- Ligjit 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, neni 12;
- Ligjit 8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, nenet 1, 6, 16, 17, 18, 19, 20 e 21;
- VKM Nr. 123 datë 15.03.2001 “Për rregullat e procesit të klasifikimit të sekretit shtetëror, procedurat që përdoren për identifikimin e tij dhe të delegimit të autoritetit të klasifikimit” kapitulli I;

konsiderohet informacion i klasifikuar “sekret shtetëror” dhe si i tillë njohja me të i nënshtrohet procedurave të parashikuara me ligj.

4. Në lidhje me numrin e përgjimeve parandaluese, duke qenë se ky informacion konsiderohet informacion “i klasifikuar”, referuar Ligjit 8457 datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror” neni 21, ju mund t’i drejtoheni institucioneve përkatëse me kërkesë për t’u pajisur me “Çertifikatë sigurie” në mënyrë që të njiheni me këtë informacion.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

PROKUROR I PËRGJITHSHËM

Adriatik LLALLA

